



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 385 Prot.

Tiranë, më datë 10.10.2019

VENDIM

Nr.317, datë 10.10.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 10.10.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi i Kullës në fshatin Turan”, Bashkia Korçë, hartuar nga specialistët e DRTK Korçë;
1. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Elva MARGARITI

